

AKTIVITET 6

TRAJNIM PËR “KËSHILLTARË NË KARRIERË” NË QENDRËN E KOMPETENCËS NË PRIZREN (KOSOVË), INSTITUCION I AKREDITUAR NGA AUTORITETI KOMBËTAR I KUALIFIKIMEVE

Për të parë nga afër risitë në fushën për orientimin për karrierë në rajon, si dhe për një shkëmbim eksperiencash, grupi ynë u bë pjesë i brezit të katërt për nivelin V të kualifikimit “Këshilltarë për Karrierë” në këtë qendër. Të gjithë kandidatët të cilët e përfundojnë me sukses këtë kualifikim, pajisen me certifikatë të nivelit V për “Këshilltarë në Karrierë” dhe kanë të drejtë të punësohen në shkolla me kohë të plotë.

Kjo ishte një eksperiencë dhe përvojë që synuam ta çojmë më tej, jo vetëm tek mësuesit koordinator të shkollës 9-vjeçare “Ismael Qemali”, ku zhvilluam praktikën, por dhe në shkollat ku ushtrojmë profesionin tonë.













